

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË DRAFT

METODOLOGJIA E LLOGARITJES SË TARIFAVE TË SHOQËRISË SË PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE AKSIONET E SË CILËS ZOTËROHEN PLOTËSISHT OSE PJESËRISHT NGA SHTETI DHE TË NGARKUAR ME DETYRIMIN E SHËRBIMIT PUBLIK

Qëllimi

Kjo metodologji është hartuar në përputhje me Ligjin Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; VKM Nr. 244 date 30.03.2016 “Per miratimin e kushteve per vendosjen e Detyrimit te Sherbimit Publik”, VKM nr. 519 datë 13.7.2016 “Për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike” akte të tjera ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë si dhe akte të tjera nënligjore të miratuara nga ERE.

Qëllimi i kësaj metodologjie është përcaktimi i tarifave për Shoqërinë e Prodhimit të Energjisë Elektrike aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti bazuar në parimet e njohura të vendosjes së tarifave të drejta e transparente mbi bazën e të dhënave të detajuara, të cilat transmetojnë sinjalet e duhura të çmimeve.

Objektivi

Kjo metodologji ka si objektivi përcaktimin e tarifës mesatare të prodhimit të energjisë elektrike. Këto tarifa do të aplikohen deri kur këto njësi të prodhimit të energjisë elektrike të hyjnë plotësisht në tregun konkurrues të energjisë elektrike.

I. Perkufizime

Termat e përdorura në këtë metodologji kanë të njëjtin kuptim si ai i përshkruar në nenin 3 e në vazhdim të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, si dhe çdo akt tjetër nënligjor të miratuar nga ERE. Termat e përdorura në këtë metodologji kanë kuptimin e mëposhtëm:

1. **Viti bazë** – periudha 12 mujore gjatë së cilës tarifa e shoqërisë së prodhimit e miratuar nga ERE aplikohet për faturat e shoqërisë së furnizuesit të shërbimit universal.
2. **Njësitë prodhuese ekzistuese** – tre hidrocentralet e kaskades se lumit Drin.
3. **Tarifa për energjinë**– një tarifë mesatare e llogaritur për njësitë ekonomike prodhuese ekzistuese në përputhje me kostot e parashikuara për vitin ushtrimor që llogaritet sipas kësaj metodologjie.

4. **Baza e rregulluar e asetëve (RAB)** – Vlera e aktiveve afatgjata që zotërohen nga njësia e prodhimit të energjisë elektrike dhe përdoren për të siguruar energji dhe kapacitet për FSHU. RAB-i është subjekt miratimi i ERE-s.
5. **Periudha rregullatore** – periudha gjatë së cilës tarifat e reja bëhen efektive dhe rregullohen/rishikohen sipas vendimit të marrë nga ERE.

II. Rregulla të përgjithshme dhe parime bazë

1. Mospajtimi me dispozitat e kësaj rregullore mund të rezultojë në refuzim të aplikimit të tarifës të shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti.
2. ERE do të vendosë tarifa bazuar në parimet e mëposhtme:
 - Tarifat duhet t'i lejojne shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike që të mbulojë kostot mesatare të shërbimit për çdo kWh që ajo lëvtron sipas Detyrimit të Shërbimit Publik. Kostoja mesatare do të jetë subjekt verifikimi në secilin prej dy viteve pasardhëse bazuar në; rezultatet e parashikuara si dhe llogaritë sipas pasqyrave financiare të audituara. Rezultati i verifikimit do të përdoret për të korrigjuar tarifën në vitet pasardhëse.
 - Shpenzimet e përfshira në tarifë duhet të jenë transparente për të gjitha palet e interesuara.
 - Vetëm shërbimet dhe produktet e blera në mënyrë të kujdesshme nga njësia e prodhimit të energjisë elektrike do të pranohen në tarifat e prodhimit.
3. Pagesat e bëra ndaj shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike për energji do të bëhen në bazë të Detyrimit të Shërbimit Publik, në përputhje me marrëveshjen për shitjen e energjisë, të bazuara në tarifat për shoqërinë e prodhimit të energjisë.
4. Tarifa e prodhimit të energjisë elektrike nuk duhet të përdoret për të mbuluar koston e ndonjë aktiviteti që nuk është i lidhur me shitjen e energjise tek Furnizuesi i Shërbimit Universal.
5. Tarifa e prodhimit të energjisë elektrike do të bazohet në kostot që do të shkaktohen nga një shoqëri prodhimi të mirëmenaxhuar e cila bën investime të kujdesshme dhe shmang shpenzimet e tepërta. Gjatë procesit të përcaktimit të tarifës së shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike, ERE ka të drejtë të kontrollojë nivelet e kostove të raportuara nga shoqëria e prodhimit dhe të krahasojë koston për njësi të saj me atë të shoqërive të tjera prodhuese në Vend dhe në Rajon.

III. Viti i testimi dhe periudhat rregullatore

1. ERE vendos për periudhat e përshtatshme të rregullimit për shoqërinë publike të prodhimit të energjisë elektrike. Proçesi i rishikimit të tarifave bëhet për rishikime vjetore të të ardhurave të kërkuara për shoqërinë e prodhimit duke përcaktuar tarifën përkatëse.
2. Periudha e parë rregullatore e aplikimit të kësaj metodologjie do të jetë viti kalendarik 2017.

IV. Prodhimi neto dhe kapaciteti prodhues i instaluar

1. Sasia totale e energjisë elektrike që do të lëvrohet në sistemin e transmetimit nga shoqëria e prodhimit të energjisë elektrike do të jetë sipas një grafiku orar të përcaktuar në marrëveshjen e shitjes së energjisë elektrike me Furnizuesin e Shërbimit Universal. Çdo mungesë ose tepriçë në sasinë e energjisë të lëvruar gjatë një ore do të jetë përgjegjësi e shoqërisë së prodhimit, e cila do t'i nënshtrohet rregullave të balancimit të administruara nga OST.
2. Sasia e energjisë elektrike të lëvruar për FSHU sipas detyrimit të shërbimit publik, përcaktohet në kontratën e lidhur me FSHU në përputhje me pikën 2 të nenit 5 të VKM 244 datë 30.03.2016 "Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik", bazuar në një regjim racional shfrytëzimi të kapaciteteve gjeneruese dhe nivelit historik mesatar vjetor.

V. Kërkesa për të ardhura për prodhimin e energjisë elektrike

1. Tarifat e rregulluara të shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike duhet të mbulojnë koston e pronësisë, ndërtimit, operimit dhe mirëmbajtjes së centraleve prodhuese, koston e digave të përdorura për prodhimin hidroenergjetik si dhe të truallit, ndërtesave, rrugëve dhe pajisjeve /instrumentave të komunikimit.
2. Shoqëria e prodhimit të energjisë elektrike duhet të raportojë në mënyrë të qartë, kostot e çdo shërbimi të rregulluar, duke përfshirë vetëm asetet dhe aktivitetet që lidhen me shërbimet e rregulluara. Metoda e shpërndarjes së kostove do të jetë e qartë dhe do të miratohet nga ERE.
3. Kostot që lidhen me marketingun dhe shitjen e energjisë elektrike dhe kapacitetit të tepërt nuk përfshihen në të ardhurat e kërkuara për shitjen e energjisë elektrike tek Furnizuesi i Shërbimit Universal.

4. Vetëm kostot ekonomikisht të justifikuara të cilat i përkasin aktivitetit të shitjes së energjisë elektrike për Furnizuesin e Sherbimit Universal do të përfshihen në llogaritjen e tarifës.
5. Në aplikimin për tarifë, shoqëria e prodhimit të energjisë elektrike do të paraqesë me saktësi të gjitha kostot deri në 100.000 lekë. Rregullatori nuk duhet të kontrollojë shifra më të vogla se 100.000 lekë, përveç rastit kur ka mosmarrëveshje lidhur me kompensimin apo pagesën ndaj personave fizike te vecantë.

VI. Norma e kthimit mbi bazën e rregulluar të aseteve (RAB)

1. Baza e rregulluar e aseteve për një shërbim të liçensuar përfshin vlerën e aktiveve afatgjata materiale edhe jomateriale, minus amortizimin e akumuluar plus komponentin e kapitalit të punës.

RAB llogaritet sipas kësaj formule:

$$RAB = A - CG - D + WC + INV$$

Ku:

| | |
|-----|--|
| RAB | Baza e Rregulluar e Aseteve |
| A | Vlera e njohur e aktiveve të dobishëm dhe në përdorim/operim në fillim të periudhës rregullatore |
| CG | Vlera e aktiveve të përftuara nëpërmjet dhurimeve |
| D | Vlera e akumuluar e amortizimit për periudhat e mëparshme të aktiveve të përdorura për të kryer aktivitetin e liçensuar. Amortizimi për investimet e reja përgjatë periudhës aktuale rregullatore do të jetë e barabartë me mesataren vjetore kumulative të amortizimit të mesvitit. |
| WC | Vlera e lejuar për kapitalin e punës |
| INV | Vlera mesatare nominale kumulative e investimeve të parashikuara për mesvitin, të miratuara nga ERE, të cilat do të investohen gjatë vitit. |

2. Jo të gjitha aktivitetet e një Shoqërie prodhimi të energjisë elektrike aksionet e së cilës zotërohen plotësisht apo pjesërisht nga shteti mund të përfshihen në bazën e rregulluar të aktiveve për qëllim të llogaritjes së tarifës së rregulluar të prodhimit të energjisë elektrike. Aktivitetet që nuk i shërbejnë qëllimit për të cilin është liçensuar do të përjashtohen nga baza e rregulluar e aseteve. Shembuj të aktiveve të përjashtuar nga RAB, përfshijnë por nuk kufizohen vetëm në, aktive të përdorura për aktivitetet e palicënuara, aktive të përdorura për argëtim, apo aktive të blera nga shoqëria e prodhimit të energjisë elektrike mbi vlerën e tregut. ERE, duke u bazuar në vlerësimin e konsulentit ose të stafit të saj, përcakton vlerën e tregut të aktiveve vetëm në ato raste kur vlera e investimit është e diskutueshme.

3. Toka dhe të drejtat e servitutit që përdoren nga shoqëria e prodhimit të energjisë elektrike aksionet e së cilës zotërohen pjesërisht apo tërësisht nga shteti mund të vlerësohen me koston origjinale të blerjes, korrigjuar me nivelin e inflacionit. Nuk është e nevojshme të përcaktohet vlera e tregut të tokës.
4. Financimet afatgjata të shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike aksionet e së cilës zotërohen pjesërisht apo tërësisht nga shteti duhen përdorur për të financuar shpenzimet kapitale për riparimin dhe rinovimin e centraleve ekzistues, por nuk duhen përdorur për të mbuluar shpenzimet operative apo ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese dhe që nuk shërbejnë për plotësimin e kërkesës së klientëve që përfitojnë nga shërbimi universal.
5. ERE do të aplikojë sistemin fiskal për llogaritjen e amortizimit për qëllime të rregullimit. ERE mund të vendosë të përdorë norma të tjera amortizimi në raste të veçanta kur shoqëria e prodhimit të energjisë elektrike mund të paraqesë studime inxhinierike në lidhje me jetëgjatësinë e aseteve.
6. Baza për përcaktimin e vlerës së lejuar të kapitalit të punës do të jetë 1/12 e shumave të elementeve të lejuar.
7. Norma e kthimit të shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike nuk duhet të reflektojë aktive të përfituara nëpërmjet dhurimit. Shoqëria e prodhimit të energjisë elektrike do të lejohet të mbulojë shpenzimet e amortizimit për këto aktive.
8. Baza e Rregulluar e Aseteve (RAB) do të llogaritet si shuma e:
 - Vleres se RAB miratuar sipas Vendimit Nr. 139 Datë 26.12.2014;
 - Vleres se investimeve per vitin 2015-2016;
 - Vleres se investimeve te parashikuar per t'u realizuar për periudhën rregullatore qe shqyrtohet sipas planit te investimeve te miratuar nga ERE;
 - minus amortizimin e akumuluar;
 - Vleres se kapitalit te punes te lejuar te barabarte me 1/12 e Shpenzimeve Operative te lejuara te periudhes per te cilen aplikohet.
9. Norma e lejuar e kthimit mbi RAB-in llogaritet sipas një norme e lejuar të kthimit mbi kapitalin në vitin bazë, një vlerësim i normës mesatare të interesit për borxhet afatgjata gjatë vitit bazë, si dhe një raport borxh/kapital i vet. Të tre këto vlera duhen dhënë në vendimin për tarifën e miratuar nga rregullatori, në mënyrë të tillë që supozimet e përdorura për të llogaritur normën e lejuar të kthimit mbi RAB-in të jenë të paraqitura qartë. Norma e lejuar e kthimit para takse mbi RAB-in është:

$$WACC = [ES * ARoE / (1-T) + DS * CoD]$$

$$ES + DS = 1$$

| | |
|------|--|
| Ku: | |
| ES | Objektivi për raportin e kapitalit të vet në RAB` |
| T | Norma e taksës |
| ARoE | Norma e lejuar e kthimit mbi kapitalin e vet pas takse |
| DS | Objektivi për raportin e borxhit të RAB |
| CoD | Kosto e borxhit |

10. ERE do të përcaktojë vlerën e përshtatshme të kthimit mbi kapitalin e vet (pas taksës) për shoqërinë e prodhimit të energjisë elektrike e cila do të jetë norma pa risk e bonove afatshkurtra të thesarit të emetuara nga Banka Qendrore e Shqipërisë.

11. Norma e interesit të komponentit të borxhit do të bazohet në normat e interesit për borxhin e papaguar të shoqërisë prodhuese. Normat e interesit të përdorura për të përcaktuar të ardhurat e kërkuara mund ose jo të jenë të njejta me normat e interesit aktuale të borxhit. Shoqëria prodhuese duhet të tregojë se normat e interesit për borxhin janë në të njëjtën linjë me normat e interesit për borxhin e supozuar nga kompani me risk të ngjashëm të kreditimit. Borxhet e përfshira në llogaritjen e normës mesatare të interesit për borxhet dhe që kanë një normë interesi shumë më të lartë se niveli aktual i tregut, do të rregullohet në rnie drejt nivelit të tregut.

11.1. Norma mesatare e ponderuar interesit për borxhet afatgjata do të përcaktohet si shuma e pagesave të interesave të borxhit afatgjatë të vitit bazë, duke e pjesëtur me totalin e principalit të borxhit afatgjatë (sasia totale e borxhit) në fillim të vitit bazë.

11.2. ERE do t'i bazojë vendimet e saj sipas një strukture kapitali prej 30% kapital i vet dhe 70% borxh për shoqërinë e prodhimit të energjisë elektrike.

VII. Rishikimi vjetor i aftësisë së shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike për të financuar shpenzimet kapitale

1. Shoqëria e prodhimit të energjisë elektrike duhet të paraqes në ERE një pasqyrë financiare vjetore për vitin më të afërt që mbaron më 31 Dhjetor si dhe parashikimin e këtyre pasqyrave për vitin bazë. Pasqyrat financiare duhet të përfshijnë një raport të fluksit të parasë që tregon burimet dhe përdorimin e fondeve.

2. Shoqëria e prodhimit të energjisë elektrike paraqet në ERE një parashikim të pasqyrave financiare për vitin bazë të cilat identifikojnë burimet e fondeve të përdorura për të mbuluar shpenzimet kapitale vjetore.

- 2.1. ERE, çdo fund viti mund të rishikojë investimet aktuale kundrejt atyre të planifikuara si dhe të ndryshojë tarifën në rast se shoqëria e prodhimit të energjisë elektrike dështon në realizimin e planit të investimeve.

VIII. Llogaritja e tarifës së prodhimit të energjisë elektrike

Tarifa e prodhimit të energjisë elektrike nga shoqëria e prodhimit të energjisë, aksionet e të cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti, për qëllim të shitjes tek Furnizuesi i Shërbimit Universal llogaritet si raport i të ardhurave të kërkuara vjetore me sasinë e energjisë elektrike të kontraktuar sipas VKM Nr. 244 datë 30.03.2016 “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik”

IX. Afatet

Bazuar në këtë metodologji, Shoqëria e prodhimit të energjisë elektrike duhet të dorëzojë në ERE aplikimin për tarifa të reja, të paktën 4 muaj përpara ditës që tarifën e propozuar të hyjnë në fuqi, në përputhje me “Rregulloren për Organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”.

X. Dispozita të fundit

Metodologjia e llogaritjes së tarifave të Shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike u miratua nga Bordi i ERE-s me Vendimin Nr. dt. Kjo metodologji zëvendëson atë të miratuar me Vendimin nr. 77 dt. 26/06/2008.